



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d), 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.05/2020 për procedurat e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, dhe neneve 14, 15 paragrafi 2.4, dhe 47 paragrafi 2 ndërlidhur me nenin 50 paragrafi 1.3 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 30 qershor 2022, mori këtë,

VENDIM PËR THEMELIMIN DHE PËRBËRJEN E KOMITETIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Neni 1

1. Themelohet Komiteti për Zhvillim Ekonomik i Kuvendit të Komunës së Podujevës, në përbërje prej 5 anëtarëve/eve, dhe atë:

- **Arjant Topanica**, anëtar, nga radhët e Kuvendit të Komunës-LDK,
- **Xhevdet Maloku**, anëtar, nga radhët e Kuvendit të Komunës-LVV,
- **Endritë Murati**, anëtare, nga radhët e Kuvendit të Komunës-PDK,
- **Burim Hasani**, anëtar, nga radhët e Kuvendit të Komunës-AAK,
- **Arjeta Fetahu**, anëtare, përfaqësuese nga jashtë Kuvendit, propozuar nga OBKD

2. Zgjedhja e kryesuesit/es të Komitetit sipas këtij vendimi, bëhet me shumicë të votave të anëtarëve të Komitetit.

Neni 2

Mandati i anëtarëve të Komitetit sipas nenit 1 të këtij vendimi, ndërlidhet dhe është në kohëzgjatje të mandatit të Kuvendit të Komunës, ndërsa ndryshimi dhe plotësimi eventual, bëhet me vendim të veçantë nga Kuvendi i Komunës.

Neni 3

Komiteti për Zhvillim Ekonomik, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me dispozitat e Ligjit për vetëqeverisje lokale, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.05/2020 për procedurat e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunë, Statutin e Komunës, Rregulloren e punës së Komiteteve, dhe dispozitat tjera përkatëse në fuqi.

Neni 4

Kompensimi i anëtarëve të Komitetit sipas këtij vendimi, për mbledhjet e mbajtura bëhet nga buxheti i Komunës dhe atë në përputhje me rregullativën ligjore në fuqi

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryesuesi i Kuvendit dhe Ekzekutivi i Komunës.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr.prot. 01-020/04-0053367/22
Podujevë, Datë: 30.06.2022



Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha